



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

**AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE**

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit, nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar mbi transaksioni i propozuar lidhur me blerjen e Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited nga Statkraft IH Holdings AS (Statkraft).

Referuar dokumentacionit të paraqitur dhe Planit të Zgjidhjes, palët janë:

Pala blerëse: Statkraft IH Holding AS, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit norvegjez, me objekt veprimtarie: Zhvillimi dhe operimi i asetëve të energjisë së rinovueshme nga energjia hidrike, e erës, diellore, gazi dhe biomasa dhe filial i Statkraft Group.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A.

Target: Lanco Mandakani Hydro Energy Private Limited, është një shoqëri private e kufizuar në kuota, e themeluar në Indi. Targeti është një mjet për qëllime të veçanta, i krijuar për të zbatuar projekte hidroelektrike në rrjedhën e lumit Mandakani (India Veriore).

Targeti nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.